




POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



Ambasada ruse në Tiranë shpërndan mesazhin e Kremlinit Zyrtar. Qëllimi i sulmit të mbrojmë popullsisë në Donbas dhe do dënojnë regjimin për krimet e kryera



Mediat thanë se një shqiptar u vra në Ukrainë, i riu e përgënjeshtroi: Jam gjallë, po luftoj krah



Zelensky flet me liderët e BE. Kjo mund të jetë hera e fundit që me shihni të gjallë



Lufta në Ukrainë/ Zelensky: Forcat ruse po përparojnë në Kiev nga veriu dhe lindja! Qëllimi ynë, ta përfundojmë këtë masakër, nuk duhet t'i besojmë rusve



Lufta/ Pritet natë e gjatë në Kiev, Zelensky: Gati për armëpushim! SHBA: Diplomacia e pamundur nën tytën e armës, Rusia të tërheqë trupat! NATO: 'Oreksi' i Putin nuk ndalet në Ukrainë

Kronikë

Dy kallashnikovë, një pistoletë dhe 4 kg kanabis në banesë, arrestohet 32-vjeçari në Vlorë

Mësohet se në shtëpinë e të riut, banues në zonën e Ujit të Ftohtë, policia gjeti tre armë zjarri. Sipas raportimeve janë sekuestruar 2 kallashnikovë dhe 1 pistoletë. Sakaq, blutë e Vlorës kanë gjetur edhe 4 kilogramë kanabis.



Foto ilustruese nga Vlorë



Redaksia

24 Shkurt, 13:21 | Përditësimi i fundit: 24 Shkurt, 13:25



Policia e Vlorës ka arrestuar një 32-vjeçar me inicialet J.Sh., në kuadër të operacionit të koduar 'Ice'.

Mësohet se në shtëpinë e të riut, banues në zonën e Ujit të Ftohtë, policia gjeti tre armë zjarri.

LEXO EDHE:

Marinsi i shkolluar në Rusi për Report Tv: Lufta e Putin e padrejtë, nuk e ndaloj djalin të mbrojë Ukrainën

Sipas raportimeve janë sekuestruar 2 kallashnikovë dhe 1 pistoletë.

Sakaq, blutë e Vlorës kanë gjetur edhe 4 kilogramë kanabis.

Njoftimi i Policisë

Finalizohet operacioni policor i koduar "Ice", për goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e narkotikëve dhe armëmbajtjes pa leje. Operacioni i zhvilluar nga Komisariati i Policisë Vlorë, në bashkëpunim me Seksionin e Hetimit të Narkotikëve dhe Trafiqueve në DVP Vlorë. Sekuestrohen 3 armë zjarri, municion luftarak dhe 4 kg kanabis. Vihet në pranga poseduesi i tyre. Në vijim të punës për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e narkotikëve dhe armëmbajtjes pa leje, bazuar dhe në informacionet e marra në rrugë policore, nga shërbimet e Komisarariatit të Policisë Vlorë, në bashkëpunim me Seksionin e Narkotikëve dhe Trafiqueve të Paligjshme në DVP Vlorë, u organizua dhe u finalizua me sukses operacioni policor "Ice".

Si rezultat i këtij operacioni u arrestua në flagrancë shtetasi J. Sh., 32 vjeç, banues në lagjen "Uji i Ftohtë", Vlorë. Shërbimet e Policisë, gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e këtij shtetasi, kanë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale 3 armë zjarri (2 kallashnikovë dhe 1 pistoletë), municion luftarak dhe 4 kg lëndë të dyshuar narkotike cannabis sativa. Materialet në ngarkim të shtetasit J. Sh. i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, për veprat penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve" dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit".

M.Ç/Shqiptarja.com

TAG: arme zjarri policia vlore Arrestime Vlore

Komento

Ndalohet repretësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:

A po reagon në mënyrën e duhur Perëndimi pas sulmit të Rusisë ndaj Ukrainës?

Po

Jo

Nuk e di

Lajme të tjera

Kronikë



Qëlloi në ajër dhe i drejtoi armën policisë, arrestohet 38-vjeçari në Kamës i dënuar më parë për drogë

25 Shkurt, 18:17

Kronikë



Tantuan të trafikojnë 6.5 kg kanabis në Korfuz, arrestohen dy të rinj, shpallet në kërkim një tjetër (EMRAT)

25 Shkurt, 13:53

Kronikë



Kanabis në xhep, dhunë në familje dhe të dehur në timon, 6 të arrestuar në Tiranë! Nën hetim 4 të tjerë, ja për çfarë akuzohen

25 Shkurt, 12:57

Kronikë



Mori kredi në emër të dikujt tjetër me dokumente false, nën hetim 37-vjeçarja në Vlorë! Pranga 45-vjeçarit që dhunoi të bijën e mitur

25 Shkurt, 12:44

Kronikë



Po pinte kafe në lokal, qëllohet me sopatë pas kurrizit 26-vjeçari në Vlorë! Policia e dërgon në spital

25 Shkurt, 11:59


Kronikë



Blindohet Vlorë, katër postbloqe kontroll makinave me xhama të zinj! Në fokus personat e rrezikshëm dhe ata që mbajnë armë pa leje

25 Shkurt, 11:10

Kronikë



Fikën serverin sapo hyri policia, arrestohen tre të rinjtë që mashtronin të huajt përmes Call Center-it në Tiranë

25 Shkurt, 10:45

Sociale



Apeloi për ndihmë në Report Tv, por nuk iu siguria mjekim jashtë shtetit! Ndërron jetë 38-vjeçarja nga Vlorë, Blerina Rapushi! Vuante nga sëmundja e elefantizmit dhe peshonte 460 kg

25 Shkurt, 07:57

Kronikë



Katër të arrestuar për kultivim kanabisi në Mat, dy në kërkim! Një tjetër në pranga për dhunë në familje

24 Shkurt, 14:32

Kronikë



Plagosën me thikë tre vajza pas një sherri, arrestohen dy të reja në Tiranë

24 Shkurt, 13:55


Kronikë



Dhunë në familje dhe tapë në timon, dy të arrestuar dhe një nën hetim në Elbasan

24 Shkurt, 13:12

Kronikë



Shiste heroinë me doza të vogla në Tiranë, arrestohet 37-vjeçari! Ja çfarë i gjeti policia në banesë

24 Shkurt, 10:46

Kodi Etik

Kontakt

Rreth Nesh

Raportoni Ju